



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVES - QYTETI I PRISHTINES  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRAN

01 Nr. / Br 250/16

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 29. 12. 2016

VUSHTRRE - VUCITRAN



Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12.1, pika "d" të Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41.2, pika "ç" të Statutit të Komunës, nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) 01/2015 për Transparencë në Komuna si dhe nenit 11.1 të Rregullores për Transparencë Nr.99/13 e datës 25.04.2013, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29 dhjetor 2016** mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË I KOMUNËN**  
**SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2017**

- 1.Me këtë vendim aprovet Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017.
- 2.Për zbatimin e këtij plani kujdesen: Kryetari i Komunës, Zyra për Komunikim me Publikun, Njësia e Personelit, Zyra Ligjore dhe Drejtoritë Komunale.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin "Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017", (i cili ka gjithsej 7 faqe).
- 4.Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



**Shpëtim Zhegrova**

**Kryesuesi i Kuvendit**



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **29 dhjetor 2016**, pas shqyrtimit të Draft-Planit Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për Vitin 2017, duke u bazuar në nenin 12.1 pika "c" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë nëpër Komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

### V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Jepet në diskutim publik Draft-Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për Vitin 2017.
2. Diskutimi publik fillon nga data 30 dhjetor 2016 dhe zgjatë deri më 20 janar 2017.
3. Obligohen: Drejtoritë Komunale të Komunës së Vushtrrisë që brenda afatit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi ti propozojnë temat që do të përfshihen në Plani Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për Vitin 2017.
4. Sekretaria e Kuvendit ka për detyrë që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime ti inkorporoj në Draft-Plani Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për Vitin 2017 dhe t'ia prezantojnë Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin janar 2017.
5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

  
Shpëtim Zhegrova  
Kryesues i Kuvendit

